

STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“STARPOKES ALBANIA” Shpk.

Sot me date 19.07.2020, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “STARPOKES ALBANIA” shpk, me kontributin e ortakeve :

- Artiola Hoxha , e bija e Bujarit, lindur me 17.10.1987, ne Permet dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike për të vepruar, identifikuar me pasaporte me nr.personal I76017054S.
- 2- Laurjan HOXHA , i biri i Bujarit , lindur me 19.04.1992 ne Permet , banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte me nr.personal J20419078B.

Nenshkruaj kete statut per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “STARPOKES” Shpk. (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

TITULLI I
EMERTIMI, OBJEKTI, ZYRA QENDRORE, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqeria eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet ne baze te ketij statuti dhe aktit te themelimit.
- 1.2. Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 2 – Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte “STARPOKES ALBANIA” Shpk.

Neni 3-Vula e Shoqerise


Shoqeria ka vulen e saj, e cila eshte ne forme katrore dhe ne te eshte e shkruar me ngjyre lejla dhe vjollce emri i shoqerise “STARPOKES ALBANIA”.

Stema e shoqerise do te jete ne formen drejtekendeshi e shkruar emri i shoqerise “STARPOKES ALBANIA “, me ngjyre me sfond lejla te erret dhe lejla te hapur .

Neni 4 – Objekti

Objekti i shoqerise “STARPOKES ALBANIA ” shpk do te jete:

Aktivitete të konsulencës kompjuterike, Teknologji të tjera të informacionit dhe aktivitete të shërbimit kompjuterik; Aktivitetet e administrimit të objekteve kompjuterike; Hapje te portaleve me ane te internetit; konsulencë ne fushen e menaxhimit te biznesit; Shitje me pakicë dhe shumice te pajisjeve kompjuterike, njësive periferike dhe softuerëve në dyqane të specializuara; Agjensi Reklamimi; Agjensi Imobiliare;



Aktivite të specializuara në fushën e projektimit; Aktivite të kombinuara të shërbimit administrativ të zyrës; Aktivite në fushën e Call Center; Aktivite të tjera telekomunikuese; Aktivitetet e programimit kompjuterik; Botime të softuerëve të tjerë; Aktivite të tjera shërbimi në mbështetje të biznesit.

Kohezgjatja e aktivitetit të kësaj shoqërie do të jetë pa afat.

Neni 4 – Zyra

4.1. Shoqëria e ka Zyren Qendrore të saj në Tiranë në adresën:

Rruga “Ibrahim Rugova ” Godina Nr.7, Hyrja 1, Ap 5, 10000 Tiranë, Shqipëri.

4.2. Ortaket e Shoqërisë mund të vendosin bashkarisht për transferimin e zyrës qendrore të Shoqërisë në një vend tjetër, ose mund të vendosin hapjen e mbylljen e degeve, filialeve apo zyrave të perfaqësimit të Shoqërisë, brenda territorit të Shqipërisë.

Neni 5 – Kohezgjatja

5.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor pa kufi.

5.2. Kohezgjatja e Shoqërisë mund të zgjatet ose Shoqëria mund të priset dhe të likujdohet përpara përfundimit të afatit të sipërpërmendur, me vendim të Ortakeve të Shoqërisë.

Neni 6 – Përgjegjësitë

6.1. Shoqëria nuk është përgjegjëse për detyrime të marra për sipër në kundërshtim me këtë statut dhe aktin themelimit.

6.2. Shoqëria nuk është përgjegjëse për detyrime të marra për sipër nga njëri prej ortakeve të sajë në emër të tij kundërshtim të tregëve.

TITULLI II KAPITALI

Neni 7 – Kontributet dhe pjesët e kapitalit


“STARPOKES” shpk do të ketë një kapital fillestar minimal prej 100.000 (njëqindmijë) lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (US\$) ose në monedhën europiane (Euro). Kapitali prej 100.000 (njëqindmijë) lekë është i ndarë në 2 (dy) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapital themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakeve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë :

1. Artiola Hoxha 1 Kuote, me vlerë 70.000 Lek, zotëron 70% (shtatëdhjetë) .

2. Luarjan Hoxha 1 Kuote, me vlerë 30.000 Lek, zotëron 30% (tridhjetë).

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet në çdo kohë sipas vendimit që mund të marrin ortaket e saj.



Neni 8 – Zmadhimi i kapitalit

8.1 Ortaket e Shoqerise mund te zmadhojne kapitalin e Shoqerise.

8.2 Per zmadhimin e kapitalit, Ortaket kane te drejte te nenshkruaje pjeset e reja te kapitalit qe do te zmadhohen.

Neni 9 – Zvogelimi i kapitalit

9.1 Ortaket e Shoqerise, mund te vendosin mbi zvogelimin e kapitalit te Shoqerise. Ne çdo rast kapitali nuk mund te zvogelohet me shume se minimumi i kerkuar nga ligji.

9.2 Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise prek ortakun ne proporcion me pjeset e kapitalit qe ai zoteron.

Neni 10 – Transferimi i pjeseve te kapitalit

10.1 Pjeset e kapitalit mund te transferohen tek te tretet, pjeserisht apo teresisht, me Vendim te Ortakeve te kompanise.

TITULLI III

VENDIMET E ORTAKEVE TE SHOQERISE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 11

Ortaket bashkarisht me vendim te Bordit vendosin ne lidhje me sa vijon:

- emerimi dhe zevendesimi i administratorit/ve dhe te ekspertit kontabel (nese eshte i emeruar);
- miratimi i te gjitha planeve te prodhimit, organizimit, zhvillimit te aktivitetit, buxhetit, bilanci vjetor, raportet e administrimit dhe ato te ekspertit kontabel, si dhe inventaret;
- ndryshimet ne statut;
- hapja e degeve, filialeve, zyrave te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit;
- zmadhim apo zvogelim te kapitalit;
- ndryshimi i objektit te shoqerise dhe shitja e pjeseve te kapitalit nje shoqerie tjeter;
- transferimi i pjeseve te kapitalit;
- emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve;
- ndarja e fitimeve dhe rezerves ligjore.


Neni 12 – Administrimi

12.1. Shoqeria do te administrohet nga nje Perfaqesues Ligjor qe do te jete Administratori.

12.2 Perfaqesuesi ligjor do te qendroje ne detyre per nje afat prej 5 (pese)- vitesh, me te drejte riparteritje te kesaj detyre, me Vendim te Ortakeve.

12.3. Perfaqesuesi Ligjor ka te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem ne lidhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji apo statuti i shoqerise ia njej shprehimisht Ortakeve.

12.4. Ortaket ne çdo moment kane te drejte te kontrollojne, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi atehere kur e shohin te arsyeshem, dhe pa asnje kufizim, veprimtarine e Perfaqesuesit ligjor. Cdo vendim i marre nga ortaket ne kundërshtim me parashikimet e ketij paragrafi, do te konsiderohet i pavlefshem.



Neni 13 - Eksperti Kontabel

- 13.1. Nese eshte e nevojshme apo nese kerkohet nga ligji, revizionimi i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise, do te behet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per nje periudhe prej 5 (pese) vitesh, me mundesi emerimi per nje afat tjeter, me vendim te Ortakut te Vetem.
- 13.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet me te njejten procedure.

Neni 14-Te drejtat e Shoqerise

- 14.1 Shoqeria vepron me te drejtat e prones private dhe merr persiper te drejtat dhe detyrimet e saja.
- 14.2 Ajo pergjigjet per detyrimet e saj kontraktore brenda kapitalit te vet si dhe me mjetet financiare te grumbulluara e te ndara sipas organit kompetent,ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi.
- 14.3 Shoqeria mund te hape llogari ne cdo banke shqiptare si dhe nuk eshte e kufizuar ne bankat jashte territorit shqiptar.

Neni 15- Punesimi i Personave

- 15.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ka te drejte te punesoje persona fizike,vendas dhe te huaj,per te realizuar qellimin e fitimit dhe zgjerimin e saj,por gjithmone me specialiste te kualifikuar,sipas vendimeve te organeve drejtuese te saj.Punesimi behet nepermjet kontrates se punes kolektive ose individuale dhe ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi per sigurimet shoqerore etj.

TITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI, SHPERNDARJA E FITIMIT

Neni 16 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.
- 16.2. Viti i pare financiar perjashtimisht fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKB) dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.
- 16.3. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventaret, raportet e Perfaqesuesit Ligjor dhe ekspertit kontabel (nese eshte i emeruar), miratohen me vendim te Ortakeve te Shoqerise.
- 16.4. Dokumentat qe lidhen me vitin financiar, duhet te miratohen brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1. Te ardhurat neto te shoqerise, pas vecimit te fondeve, nese do te percaktohen te tille, perftohen nga Ortaket e Shoqerise "STARPOKES ALBANIA"shpk.
- 17.2. Ortaket e Shoqerise, kur e shohin te arsyeshme, me vendim te Bordit, mund te marrin vendime per te krijuar rezerva te veçanta ose te jashtezakonshme per qellime te veçanta, edhe ne rast te shtyrjes se shperndarjes se fitimit pjeserisht apo teresisht.



**TITULLI V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Neni 18 – Prishja

- 18.1. Shoqeria mund te prishet ne çdo kohe, me vendim te Ortakeve.
- 18.2. Shoqeria nuk mund te prishet ne rast pamundesie per te vepruar, pazotesi juridike per te vepruar, vdekje, likuidimi apo falimentimi te Ortakeve.

Neni 19 – Likuiditeti

- 19.1. Ne rast prishjeje, shoqeria duhet ti nenshtrohet procedurave te likuiditetit.
- 19.2. Per perndjekjen e kesaj procedure, Ortaket emerojne nje apo me shume likuidues, te cilet duhet te pergatisin nje raport perfundimtar mbi asetet dhe detyrimet e shoqerise, si dhe mbi veprimet e procedures se likuiditetit dhe kohes se nevojshme per likuidimin.
- 19.3. Ne perfundim te procedures se likuiditetit, Ortaket e shoqerise do te vendosin, bazuar ne bilancin vjetor perfundimtar, punen e kryer nga likuiduesi/t dhe perfundimin e procesit te likuidimit.
- 19.4. Pasi te jene shlyer te gjithe kreditorët dhe debite e tjera, likuiduesi/t do te shperndajne te ardhurat e mbetura te perftuara nga likuidimi, tek Ortaket.

Neni 20 – Transformimi ne nje shoqeri tjetër

- 20.1. Shoqeria mund te transformohet ne nje shoqeri kolektive me vendim te ortakeve, dhe mund te transformohet gjithashtu ne nje shoqeri anonime perseri me vendim te Ortakeve.

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 21.1. Te gjitha mosmarreshjet qe do te lindin ndermjet paleve lidhur me interpretimin apo zbatimin e statutit dhe aktit te themelimit, do te zgjidhen me Ndermjetesim ndermjet paleve.
- 21.2. Atehere kur kjo nuk do te jete e mundur, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, do te jete organi kompetent per zgjidhjen e tyre.

Neni 22- Dispozita te Pergjithshme

- 22.1. Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet ortakeve te vetem te shoqerise per plotesim si dhe ligjeve te vacanta ne fuqi.
- 22.2. Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen nxirret vete statuti.
- 22.3. Ky statut hyn ne fuqi nga dita e nxjerrjes se tij dhe rregjistrimit ne QKB.
Ai nenshkruhet rregullisht nga ortaket e vetem te shoqerise.

Neni 23 – Gjuha e Statutit

Ky statut hartohet ne 5 (pese) kopje, ne gjuhen shqipe me vlere te barabarte juridike secila.

Nenshkruar sot me date 19.07.2020

ORTAKET

Artiola HOXHA

Artiola Hoxha
Artiola

Laurjan HOXHA

Laurjan Hoxha
Laurjan